

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY
AKT PËRCJELLËS

Për:	- Spitali i Përgjithshëm " Dr.SamiHaxhibeqiri" – Mitrovicë - Parashtruesin e ankesës, Operatorin Ekonomik - "Kosovamed Healthcare" Shpk – Prishtinë	Kopje:	Paneli Shqyrtues në OSHP, Arkives në OSHP
Prej:	Hysni Muhadri – Ekspert shqyrtues i prokurimit Kreshnik Spahiu – Ekspert i jashtëm teknik		
Lënda:	Raport i ekspertit shqyrtues/teknik, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE- "Kosovamed Healthcare" ShPK- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me pajisje mjekësore", me numër të prokurimit 70040-19-011-121, publikuar nga Autoriteti Kontraktues –Spitali i Përgjithshëm " Dr.Sami Haxhibeqiri" – Mitrovicë		
Datë	28.06.2019		

Të nderuar,

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin lidhur me ankesën me numër 309/19 të datës 13.06.2019, parashtruar nga OE- "Kosovamed Healthcare" ShPK -Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me pajisje mjekësore", me numër të prokurimit 70040-19-011-121, publikuar nga Autoriteti Kontraktues(AK) – Spitali i Përgjithshëm " Dr.Sami Haxhibeqiri" – Mitrovicë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë procedurë të prokurimit, përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojë sipas kërkesave të Nenit 115 të LPP-së. Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

Ti dorëzohet:


- Autoritetit Kontraktues - Spitali i Përgjithshëm " Dr.Sami Haxhibeqiri", Mitrovicë
- Panelit Shqyrtues në OSHP
- OE ankues -"Kosovamed Healthcare" ShPK



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES – TEKNIK

	20.06.2019	21.06.2019	28.06.2019
<i>Nënshkrimi i ekspertitshqyrtues / teknik</i>	<i>Data e autorizimit të Ekspertit shqyrtues / teknik</i>	<i>Data e fillimit të ekspertizës</i>	<i>Data e dorëzimit të raportit</i>

Neni 99 i LPP-së; Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë 13.06.2019, OE -“Kosovamed Healthcare” ShPK, - Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP kundër njoftimit për kontratë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pajisje mjekësore”, me numër të prokurimit 70040-19-011-121, publikuar nga AK – Spitali i Përgjithshëm “Dr.Sami Haxhibeqiri”, Mitrovicë.

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti shqyrtues/teknik ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet ankimore sipas nenit 113, te LPP-së.

Neni 109 i LPP-së; Operatori Ekonomik “KOSOVAMED HEALTHCARE” SHPK - Prishtinë

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues:

Neni 7 -Barazia në Trajtim / Jo Diskriminimi
Neni 28 – Specifikimet teknike;
Neni 60 – Kriteri për Dhënie të Kontratë;
NENI 108/A – Zgjedhja preliminare e mosmarrëveshjeve;

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

OE "KosovaMed Healthcare"ShPK, si palë e interesuar me aktivitetin e prokurimit: Spitali i Përgjithshëm "Dr.Sami Haxhibeqiri"- Mitrovicë Nr i Prokurimit 70040-19-2793-1-2-1 Nr i brendshëm 70040-19-011-121 Furnizim me Pajisje Mjekësorë (5.Llote)

Grupi 2. Furnizim me pajisje për funksionalizimin e artroskopit për repartin e ortopedisë.

Grupi 3. Furnizim me pajisje për funksionalizimin e resektoskopit dhe urethrotomit për repartin e urologjisë.

Të nderuar, në afatet ligjore kemi bërë ankese (22.05.2019 kërkesë për rishqyrtim) në AK-Spitali i përgjithshëm "S.Haxhibeqiri" - Mitrovicë sipas nenit 108/A.

Të funksionalizimi i shtyllës së Artroskopit ku kemi vërejtur se GRUPI 2 se pjesët e kërkuara nuk janë për prodhuesin Storz siç është pretenduar në dosje të tenderit dhe në specifika teknike por shtylla ekzistuese që gjendet në Spitalin e Mitrovicës është Richard Wolf, pas kërkesës sonë për rishqyrtim me argumentet që i kemi dorëzuar dhe pasi e kanë verifikuar gjendjen ekzistuese Artroskopit në Repartin e Ortopedisë, si dhe GRUPI 3 Resektoskopit dhe Urotomit në repartin e Urologjisë në Spital, AK ka ndryshuar titullin në dosje të tenderit dhe ka shtuar + -15 % variacion në specifikim teknik Por ende kanë mbetur specifikimet teknike sipas prodhuesit Karl Storz. Kjo pamundëson pjesëmarrjen në këto kushte si dhe zgjedh direkt fitues OE që reprezenton Karl Storz në Kosovë Kemi kërkuar nga AK anulimin e lotove të lartpërmendura dhe të rishpallen këto lloje me specifika të duhura për pajisjen ekzistuese, por AK ka ndërruar vetëm Nen-Titullin. PROV: Kërkesa për rishqyrtim dërguar AK-si me datë 22.05.2019.

Të nderuar, në afatet ligjore kemi bërë ankese (30.05.2019 kërkesë për rishqyrtim) në AK-Spitali i përgjithshëm "S.Haxhibeqiri" - Mitrovicë sipas nenit 108/A Grupi 2 Furnizim me pajisje për funksionalizimin e Artroskopit për repartin e Ortopedisë. Grupi 3 Furnizim me pajisje për funksionalizimin e Resektoskopit dhe urethrotomit për repartin e Urologjisë K ka bërë ndryshim sa i përket përshkrimit por jo të specifikat teknike Sqarim: Pajisja ekzistuese është Richard Wolf, në këtë lloje specifikat e kërkuara të jenë kompatible-ekuivalente me shtyllën ekzistuese. Lista e instrumenteve dimensionet mund të kenë variacion + -15 % . " Në si OE, të specializuar dhe distributor të prodhuesit Gjerman Richard Wolf, kemi shikuar me kujdes specifikimin teknik të këtyre dy lotove Është shqetësues fakti që për pajisjen që ju e keni "Richard Wolf" keni kërkuar pjesë të përpiluara ekskluzivisht për Karl Storz.

Pra dhe më shumë na shqetëson fakti që për Grupin 1 "Furnizim me pajisjeshtesë për sistemin ekzistues FESS të prodhuesit Karl Storz dhe pajisje tjera për ORL" Ju përdorni standardin e rregullt dhe profesional për pjesë shtesë ose për funksionalizim të drejtë dhe të saktë që për Pajisjen ekzistuese Karl Storz të sigurohen pjesët adekuate, por tek Grupi 2 dhe Grupi 3 nuk e aplikoni formën e njëjtë dhe obligative të kërkesës së pjesëve Origjinale për Richard Wolf por e leni të lajthitur, e kemi cekur që me e keqja është se i vendosni pjesë Karl Storz për aparatin Richard Wolf! Duke rrezikuar të gjitha këto mjete të shpenzohen kot dhe njëheri OE Profesional të Autorizuar nga Richard Wolf e përjashtoni padrejtësisht nga ky aktivitet. Ju informojmë për rrezikun që këto pajisje nuk do përshtaten dhe rrezikoni operacionet dhe diagnostikën që kryhet në këto salla me këto specifika! Fjalët "kompatible - ekuivalente" nuk përkojnë me kirurgjinë laparoskopike aq më pak kur vendosen pjesë jo origjinale RICHARD WOLF të blihen dhe të rrezikohet pacienti po ashtu buxheti i taksapaguesve të Republikës së Kosovës.

Kemi kërkuar nga titulli i lartpërmendur AK-Spitali Mitrovicë

Lloji 2. Furnizim me pajisje për funksionalizimin e Artroskopit për repartin e Ortopedisë - Të kërkohej (ndryshohet siç është kërkuar në grupin 1) në Furnizim me pajisje shtesë për Artroskopi në Repartin e

Ortopedisë- Richard Wolf e kërkohet vërtetimi i prodhuesit RICHARD WOLF- Original për pjesë origjinale - Te përpilohen (ndryshohen komplet) specifikat -pjesët Origjinale për Richard Wolf dhe jo specifikim i pasakte, qoftë nga Njësia Kërkuese ose nga ekspertët e SHSKUK. Te largohet +/- 15 % variacioni sepse është pasaktë në pajisje të fushës së tillë !

Llote 3.Furnizim me pajisje për Funkcionalizimin e Resektoskopit dhe urethrotomit për repartin e Urologjisë - Te kërkohet (ndryshohet siç është kërkuar në grupin 1) në Furnizim me pajisje shtesë për Funkcionalizimin e Resektoskopit dhe urethrotomit për repartin e Urologjisë Richard Wolf - Te kërkohet vërtetimi i prodhuesit RICHARD WOLF Original për pjesë origjinale

-Te përpilohen (ndryshohen komplet) specifikat pjesët Origjinale për Richard Wolf dhe jo specifikim i pasaktë, qoftë nga Njësia Kërkuese ose nga ekspertët e SHSKUK.

-Te largohet +/- 15 % variacioni sepse është e pasaktë në pajisje të fushës së tillë 1 Në kërkojmë sikurse kanë kërkuar AK te LOT 1 specifikisht për Storz, po ashtu të kërkojmë për LOT 2 dhe LOT 3 specifikat për Wolf, por përkundër kërkesave tona për ri-shqyrtim LOT2 dhe LOT3 ende mbeten të përshtatur për një prodhues Karl Storz.

Kërkojmë rregullimin e kërkesave dhe titullit të lotove të lartpërmendura dhe të ri-shpallen këto llote me specifika të duhura dhe të hapura për të gjithë operatorët, nuk po kërkojmë më shumë se sa siç e keni bërë në Grupi 1 apo LOT1.

PROV: Kërkesa për rishqyrtim dërguar AK-se me datë 30.05.2019.

Në si Operator Ekonomik Kërkojmë nga ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT PUBLIK që të bëhet trajtimi i barabartë i OE në secilin lot dhe tenderin në fjalë ta ktheni në RI-TENDER.

Procesi i prokurimit

- Data e publikimit të njoftimit për kontratë:06.05.2019
- Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur
- Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....Furnizim / Vlerë e mesme
- Vlera e parashikuar e kontratës:.....100.000,00€
- Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....Çmimi më i ulët
- Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....17.06.2019
- Data e kërkesës për rishqyrtim.....30.05.2019
- Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....05.06.2019

Kriteret për vlerësim

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin Nr. 04 L- 042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2.
2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.
3. Vërtetimin nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit.- Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmërisë”- të jetë i lëshuar së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratë nën betim (Origjinal).
2. Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore për tremujorin e fundit
3. Vërtetimin nga Gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit (ne origjinale ose kopje e noterizuar) Dokumentet (nën 2,3) do kërkojnë vetëm nga Operatorët Ekonomik fitues të cilit synohet dhënia e kontratës, para publikimit të dhënies së kontratës, Dështim në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tyre do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë.

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale:

1. Regjistri i operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit.
2. Certifikata e TVSH-së
3. Certifikata e numrit fiskal.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës i publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilën evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (B05 Njoftim për Kontratë 5 7kopja e regjistrimit të biznesit së bashku me informatorin e veprimtarisë)
2. Kopja e Certifikatës së TVSH.
3. Kopja e Certifikatës të numrit fiskal.

Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Autorizimin
2. ISO 9001 Standarde
3. ISO 13485 Standarde
4. CE Certifikata
5. Katallogje
6. OE duhet të ketë realizuar kontrata të natyrës së ngjashme për 3 vitet e fundit, nga data e publikimit të njoftimit për kontratë.

7. Licencën nga AKPPM
8. Garancionin
9. Deklarata nga Prodhuesi, Kjo vlen vetëm për lotin 2 dhe 3.
10. Deklarata nga OE , kjo vlen vetëm për lotin 2 dhe 3

Dëshmitë e kërkuara dokumentare

1. Autorizimin për Shitjen Dhe Servisim Nga Prodhuesi Ose Dileri i Autorizuar
2. ISO 9001 Certifikata
3. ISO 13485 Certifikata
4. CE Certifikata Sipas Direktivave 93 / 42 EEC Për Pajisje Mjekësore
5. Katalog për çdo Produkt të Ofruar me Specifika të Nënvizuara
6. Listën e kontratave të realizuara të natyrës së ngjashme dhe së paku 3 referenca pozitive.
7. Licenca nga AKPPM si depo me Shumice Për Pajisje Mjekësore
8. Garancioni për Pajisje Mjekësore të Ofruara 24 Muaj
9. Deklarata nga prodhuesi që instrumentet dhe pajisjet të jenë kompatible me shtyllën ekzistuese. Kjo vlen vetëm për lotin 2 dhe 3.
10. Deklarata nga OE që pajisjet e ofruara të bëjnë instalimin dhe funksionalizimin e tyre.

Neni 113 dhe 114 i LPP-së; Analiza dhe konstatimet e Ekspertit shqyrtues / teknik, sipas anesës së OE “Kosovamed Healthcare” ShPK

Sqarim hyrës: Autoriteti Kontraktues -Spitali i Përgjithshëm " Dr.Sami Haxhibeqiri", Mitrovicë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është furnizim, me vlerë të mesme. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër specifikimeve teknike në fletën e dosjes së tenderit për Lot 2 dhe Lot 3. Kundër njoftimit për kontratë parashtruesi i ankesës “Kosovamed Healthcare” ShPK, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim dy herë tek AK, me datë: 27.05.2019 dhe 30.05.2019.

Përgjigje në pretendimet ankimore: Në lidhje me pretendimet ankimore të OE për përshtatje të specifikimeve teknike në Lot 2 dhe 3 për prodhuesin Karl Storz, eksperti teknik në bazë të kërtime të bëra ka gjetur se, pajisjet e kërkuara nga AK, e të specifikuara në dosjen e tenderit janë identike me pajisjet e prodhuesit Karl Storz, bazuar në elementet e specifikuar. Kjo mund të vërtetohet duke krahasuar specifikimin si në FDT me produktet e prodhuesit. Si shembull janë paraqitur krahasimet për 3 pozicione për secilin Lot, përmes të cilave vërehet se specifikimet janë identike.

Lot 2

	Specifikimi në FDT	Secifikimi i produkteve të Kal Storz
1	Arthroscope Sheath with traditional coupling mechanism, diameter 5.5 mm, working length 12 cm,	Arthroscope Sheath with standard coupling mechanism, diameter 5.5 mm, working length 12 cm, two stopcocks,

	two stopcocks, rotatable for use with telescopes 0°, 30°, 70° and Obturators	fixed for use with HOPKINS telescopes 0°, 30°, 70° and Obturators 28126 BC/BTBS, 28134 O,
3	Punch, through-cutting, cutting width 3.4 mm, straight jaws, sheath diameter 3 mm, straight, handle with cleaning connector, working length 12 cm	SILCUT® Punch, through-cutting, cutting width 3.4 mm, straight jaws, sheath diameter 3 mm, straight, handle with cleaning connector, working length 12 cm
4	Punch, through-cutting, cutting width 3.4 mm, curved jaws, 15° upwards, sheath diameter 3 mm, straight, handle with cleaning connector, working length 12 cm	SILCUT® Punch, through-cutting, cutting width 3.4 mm, curved jaws, 15° upwards, sheath diameter 3 mm, straight, handle with cleaning connector, working length 12 cm

Lot 3

	Specifikimi në FDT	Secifikimi i produkteve të Kal Storz
1	Rigid endoscope-Telescope 12°, diameter 4 mm, length 30 cm, autoclavable, fiber optic light transmission incorporated	HOPKINS® Telescope 12°, enlarged view, diameter 4 mm, length 30 cm, autoclavable, fiber optic light transmission incorporated,
2	Resectoscope Sheath, 26 Fr., oblique beak, fixed inner sheath with ceramic insulation, consisting of: Resectoscope Sheath, Inner Sheath 2 x Connecting Tube for In- and Outflow	Resectoscope Sheath, including connecting tube for in- and outflow, 28 Fr., oblique beak, rotating inner sheath with ceramic insulation
4	SACHSE Urethrotome Sheath, 21 Fr., with channel for FILIFORM bougies consisting of: SACHSE Urethrotome Sheath and 2 LUER-Lock cones	SACHSE Urethrotome Sheath, 21 Fr., with channel for FILIFORM bougies and 2 LUER-Lock cones

Bazuar në sqarimet e mësipërme pretendimi ankimor është i qëndrueshëm pasi që specifikimi teknik në Lot 2 dhe 3 është përshatur për pajisjet e prodhuesit Kal Storz. Si të tilla specifikimet diskriminojnë OE ankues dhe OE tjerë potencial dhe janë në kundërshtim me Nenin 28 të LPP-së, përkatësisht paragrafin 2.

Andaj rekomandimi është që AK të bëjë përmirësime në specifikimet teknike, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë.

Mendimi i ekspertëve shqyrtues/teknik

Duke u bazuar në sqarimet e cekura në raport, Ekspertët shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues -“Kosovamed Healthcare” ShPK – Prishtinë, të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe të obligohet AK që të përmirësoj specifikimet teknike të aneksit 1 të dosjes së tenderit, në pajtim me Nenin 28 të LPP-së, dhe ti njoftoi operatorët ekonomik të interesuar me ndryshimet e dosjes së tenderit, dhe të bëjë zgjatjen e afatit .